**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA SHKODËR**
**KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 0488 prot Shkodër, më 26.6.2022

**N J O F T I M**

Për keshillim me publikun

Në mbështetje dhe zbatim të nenit 18 dhe nenit 54 shkronja "f", të ligjit nr.139/2015 "Për betëqeverisjen vendore", këshilli bashkiak Shkodër, njofton zhvillimin e seancës së këshillimit me publikun, për diskutim të dokumentit:

1. Për një shtesë në VKB nr.1, datë 22.1.2016 "Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Shkodër"

Takimi do të zhvillohet:

- Në sallën e mbledhjeve të këshillit bashkiak, Shkodër, **ditën e enjte, datë 14 Korrik, 2022 ora 12:00**

Gjithashtu, sugjerimet, komentet, mund të dërgohen ***deri me datë 28.7.2022***, me shkrim pranë Bashkisë Shkodër, me postë, apo nëpërmjet email në adresën:
keshillibashkiak@bashkiashkoder.gov.al

*Bashkëlidhur projektvendimi për konsultim*

*Duke ju falenderuar*

**Sekretar i këshillit**

**Denis Lesha**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KRYETARI

Nr. 1037 Prot

Shkodër, më 24 . 6 .2022

Lënda: Dërgohet për shqyrtim projekt-vendimi dhe relacioni.

**KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR**

Të nderuar Këshilltarë,

Bashkëngjitur Ju dërgojmë për shqyrtim projekt-vendimin dhe relacionin: "Për një shtesë në VKBnr. 1, dt.22.01.2016 "Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Shkodër" të ndryshuar;

Duke ju uruar punë të mbarë!

Me respekt,

KRYETARI

BARDH SPAHIA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË-BASHKIA SHKODËR

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1, Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA SHKODËR**
**KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 0488 prot                                                                 Shkodër, më 26.6.2022

# NJOFTIM

Për keshillim me publikun

Në mbështetje dhe zbatim të nenit 18 dhe nenit 54 shkronja "f", të ligjit nr.139/2015 "Për betëqeverisjen vendore", këshilli bashkiak Shkodër, njofton zhvillimin e seancës së këshillimit me publikun, për diskutim të dokumentit:

1. Për një shtesë në VKB nr.1, datë 22.1.2016 "Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Shkodër"

Takimi do të zhvillohet:

- Në sallën e mbledhjeve të këshillit bashkiak, Shkodër, **ditën e enjte, datë 14 Korrik, 2022 ora 12:00**

Gjithashtu, sugjerimet, komentet, mund të dërgohen ***deri me datë 28.7.2022***, me shkrim pranë Bashkisë Shkodër, me postë, apo nëpërmjet email në adresën: keshillibashkiak@bashkiashkoder.gov.al

*Bashkëlidhur projektvendimi për konsultim*

*Duke ju falenderuar*

**Sekretar i këshillit**

**Denis Lesha**

*Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1, Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: keshillibashkiak@bashkiashkoder.gov.al*

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA SHKODËR**

Nr._____ Prot

Shkodër, më ____.____.2022

**PROJEKT – VENDIM**

**Nr.______, datë ____._____.2022**

**"PËR NJË SHTESË NË VKB NR. 1, DT. 22.01.2016 'PËR MIRATIMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË BASHKINË SHKODËR',TË NDRYSHUAR"**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës ____._____.2022, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 23 të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar; ligji nr.8308,datë 18.03.1998 "Për transportet rrugore" të ndryshuar; neni 1 germa 'c' ligji nr.68/2017 'Për financat vendore'; ligji nr.9632,datë 30.10.2006 'Për sistemin e taksave vendore' të ndryshuar; pika 4.1 e udhëzimit nr.8885,datë 07.11.2016 "Për kushtet dhe kriteret që duhet të plotësojnë subjektet për transportin rrugor turistik" të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes dhe Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës; VKB nr.1, datë 22.01.2016 "Për taksat dhe tarifat vendore" të ndryshuar; Shkresë nr.72/1 prot, datë 02.03.2022 'Kthim përgjigje' e Ministrisë Infrastrukturës dhe Energjisë ; Relacionit të administratës së Bashkisë Shkodër nr_____, datë _______

**VENDOSI:**

1. Të miratojë një shtesë në VKB nr.1, datë 22.01.2016 "Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Shkodër" të ndryshuar :

   **"Tarifa për librin e udhëtimit"**, Kapitulli III, paragrafi III.4.3 "Tarifa për shërbimin në fushën e transportit të pasagjerëve dhe mallrave, dhënien e lejeve për ushtrim aktiviteti", pika 13. "Libri i udhëtimit për shërbimet turistike/të rastit të udhëtarëve brenda vendit (nr. fletëve/nr. udhëtimeve 25)", sipas tabelës nr. 23 "Tarifat e licensimit të veprimtarive të transportit", bashkalidhur këtij projekt-vendimi.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**KRYETARI**

**BARDH SPAHIA**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA SHKODËR

*Zv. Kryetar*

Ardit Sylbyli

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1, Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al

*Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Ndjekjes së Investimeve të Infrastrukturës:*

_______________________

*Drejtoria Juridike:*

Fisnik Lutfija
_______________________

*Drejtoria e të Ardhurave:*

_______________________

### *III.4.3 Tarifa për shërbimin në fushën e transportit të pasagjerëve dhe mallrave, dhënien e lejeve për ushtrim aktiviteti*

**Tabelë 23 Tarifat e liçensimit të veprimtarive të transportit**

| | Tarifat e liçensimit të transportit të udhëtarëve | Njësia | Tarifa |
|---|---|---|---|
| 1. | Liçensë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt qytetëse | Lekë/10 vjet/linjë | 80,000 |
| 2. | Çertifikatë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt qytetëse | Lekë/mjet/5vjet | 5,000 |
| 3. | Liçensë për transport udhëtarësh në linjë te rregullt rrethqytetëse | Lekë/10 vjet/linjë | 40,000 |
| 4. | Çertifikatë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt rrethqytetëse | Lekë/mjet/5vjet | 7,500 |
| 5. | Liçensë për kryerjen e shërbimeve të rregullta të specializuara të transportit të udhtarëve brenda vendit | Lekë/5 vjet | 20,000 |
| 6. | Çertifikatë për kryerjen e shërbimeve të specializuara të transportit të udhëtarëve brenda vendit | Lekë/5 vjet | 7,500 |
| 7. | Liçensë për kryerjen e shërbimeve vajtje – ardhje (lavjerrës) të transportit të udhëtarëve brenda vendit | Lekë/5 vjet | 20,000 |
| 8. | Çertifikatë për kryerjen e shërbimeve vajtje - ardhje të transportit të udhëtarëve brenda vendit | Lekë/5 vjet | 7,500 |
| 9 | Çertifikatë për kryerjen e operacioneve të transportit për llogari të vet brenda vendit | Lekë/5 vjet | 7,500 |
| 10. | Liçensë për agjensi transporti udhëtarësh dhe taksi brenda vendit | Lekë/5 vjet | 15,000 |
| 11. | Liçensë për agjensi ndërkombëtare udhëtarësh | Lekë/5 vjet | 40,000 |
| 12. | Liçensë për transport udhëtarësh me taksi brenda vendit | Lekë/5 vjet | 20,000 |
| 13. | Libri i udhëtimit për shërbimet turistike/të rastit të udhëtarëve brenda vendit (nr. fletëve /nr. udhëtimeve 25) | Lekë Për libër/pa afat | 5,000 |

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA SHKODËR**
**DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE,**
**NDJEKJES SË INVESTIMEVE TË INFRASTRUKTURËS**

Nr._____ Prot Shkodër, më ____.____.2022

# RELACION

## PËR NJË SHTESË NË VKB NR. 1, DT. 22.01.2016 'PËR MIRATIMIN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË BASHKINË SHKODËR',TË NDRYSHUAR"

## KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR

Të nderuar Këshilltarë,

Në zbatim të Ligjit Nr. 8308, datë 18. 03. 1998 "Për transportet rrugore" të ndryshuar, Udhëzimit Nr. 8885, datë 07.11.2016 të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes, Nr. 5402/2, datë 24.11.2016 të Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës "Për kushtet dhe kriteret që duhet të plotësojnë subjektet për transportin rrugor turistik" pika 4.1, është shtuar shërbimi i ri për pajisje me librin e udhëtimit subjekteve që kryejnë shërbimet turistike/të rastit të udhëtarëve brenda vendit.

Libri i udhëtimit jep të drejtën subjekteve për kryerjene shërbimeve turistike/të rastit të udhëtarëvebrenda vendit, që janë:

- udhëtimet me dyer të mbyllura ku i njëjti autobusdo të transportojë të njëjtin grup udhëtarësh për gjatë gjithëudhëtimit dhe do t`i sjellëpërsëri nëpikën nga ku u nisën.
- shërbime qëkryejnëudhëtimin nëvajtje me ngarkesëdhe udhëtimin e kthimit pa ngarkesëpika e nisjes ështënëvendin ku është vendosur operatori i transportit
- shërbime gjatëtëcilave udhëtimi nëvajtje është kryer pangarkesëdhe gjithë udhëtarëttëtransportuar mëparënga i njëjti operator transporti kanëkryer udhëtimin e kthimit nëpikën e nisjes.

Me shkresën Nr. 72 Prot, datë 02.04.2022, MinistriaInfrastrukturës dhe Energjisë në kthim përgjigje "Vendosja etarifëssë librit të udhëtimit për pajisjen e subjekteve që kryejnë këto shërbime, përcaktohet dhe vendoset nga njësia e qeverisjes vendore, në të cilën ka selinë operatori turistik, ku si rrjedhojë NJVV është përfituese e të ardhurave përkundrejt shërbimit të ofruar.

Sa më sipër në zbatim të dispozitave ligjore i propozojmë Këshillit Bashkiakpër një shtesë nëVKB nr. 1, dt. 22.01.2016 "Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Shkodër", të ndryshuar si më poshte:

Meqenëse çmimi i miratuar nga Ministria e Financës në vitin 2010 nuk ka ndryshuar. Propozojmë miratimin e tarifës për librin e udhëtimit Kapitulli III, paragrafi III.4.3 "Tarifa për shërbimin në fushën e transportit tëpasagjerëve dhe mallrave , dhënien e lejeve për ushtrim aktiviteti", pika 13.

"Libri i udhëtimit për shërbimet turistike/të rastit të udhëtarëve brenda vendit (nr. fletëve /nr. udhëtimeve 25)", të jetë në vlerën 5000 lekë (per libër), sipas tabelës nr. 23 "Tarifa e licensimit të veprimtarive të transportit", bashkalidhur relacionit.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.

**DREJTORI**

**ALFRED LULETA**

Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Ndjekjes së Investimeve të Infrastrukturës

## *III.4.3 Tarifa për shërbimin në fushën e transportit të pasagjerëve dhe mallrave, dhënien e lejeve për ushtrim aktiviteti*

**Tabelë 23 Tarifat e liçensimit të veprimtarive të transportit**

| | Tarifat e liçensimit të transportit të udhëtarëve | Njësia | Tarifa |
|---|---|---|---|
| 1. | Liçensë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt qytetëse | Lekë/10 vjet/linjë | 80,000 |
| 2. | Çertifikatë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt qytetëse | Lekë/mjet/5vjet | 5,000 |
| 3. | Liçensë për transport udhëtarësh në linjë te rregullt rrethqytetëse | Lekë/10 vjet/linjë | 40,000 |
| 4. | Çertifikatë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt rrethqytetëse | Lekë/mjet/5vjet | 7,500 |
| 5. | Liçensë për kryerjen e shërbimeve të rregullta të specializuara të transportit të udhtarëve brenda vendit | Lekë/5 vjet | 20,000 |
| 6. | Çertifikatë për kryerjen e shërbimeve të specializuara të transportit të udhëtarëve brenda vendit | Lekë/5 vjet | 7,500 |
| 7. | Liçensë për kryerjen e shërbimeve vajtje – ardhje (lavjerrës) të transportit të udhëtarëve brenda vendit | Lekë/5 vjet | 20,000 |
| 8. | Çertifikatë për kryerjen e shërbimeve vajtje - ardhje të transportit të udhëtarëve brenda vendit | Lekë/5 vjet | 7,500 |
| 9 | Çertifikatë për kryerjen e operacioneve të transportit për llogari të vet brenda vendit | Lekë/5 vjet | 7,500 |
| 10. | Liçensë për agjensi transporti udhëtarësh dhe taksi brenda vendit | Lekë/5 vjet | 15,000 |
| 11. | Liçensë për agjensi ndërkombëtare udhëtarësh | Lekë/5 vjet | 40,000 |
| 12. | Liçensë për transport udhëtarësh me taksi brenda vendit | Lekë/5 vjet | 20,000 |
| 13. | Libri i udhëtimit për shërbimet turistike/të rastit të udhëtarëve brenda vendit (nr. fletëve /nr. udhëtimeve 25) | Lekë Për libër/pa afat | 5,000 |